

**KOMISIONI PËR MBROTJEN E TË DREJTËS PËR ÇASJE TË LIRË NË  
INFORMACIONE ME KARAKTER PUBLIK**

**RAPORTI VJETOR**

**për punën e Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për çasje  
të lirë në informacionet me karakter publik  
prej 1 janar deri 31 dhjetor të vitit 2008**

**Shkup, mars 2009**

## **Përmbajtja**

<b>1.</b>	<b>Hyrje.....</b>	<b>2</b>
<b>2.</b>	<b>Kompetencat e Komisionit.....</b>	<b>3</b>
2.1	Vendim për ankesa.....	5
2.1.1	Procesi për ankesë .....	6
2.1.2	Lëndë të zgjedhura dhe struktura e tyre.....	6
2.1.3	Ankesa të dorëzuara kundër poseduesve të informacioneve.....	7
2.1.4	Karakterit i ankesave të dorëzuara.....	8
2.1.5	Gjendja e lëndëve pas padive.....	8
<b>3.</b>	<b>Zbatime dhe përvoja nga zbatimi i Ligjit.....</b>	<b>8</b>
<b>4.</b>	<b>Lista e poseduesve të informacioneve.....</b>	<b>11</b>
4.1	Përmbajtja e raporteve vjetore.....	12
4.2	Raportet vjetore të poseduesve.....	13
4.3	Bashkëpunim me persona zyrtar.....	15
4.4	Raporte jo të plota dhe parregullsi të evidentuara.....	16
4.5	Vetpërrjashtim nga ligji.....	18
<b>5.</b>	<b>Edukim dhe trajnime.....</b>	<b>18</b>
5.1	Transparencë në punën e Komisionit.....	19
5.2	Ueb faqja.....	20
5.3	Bashkëpunim ndërkombëtar.....	21
<b>6.</b>	<b>Buxheti.....</b>	<b>22</b>

## **RAPORTI VJETOR**

### **për punën e Komisionit për mbrojtjen e të drejtës për çasje të lirë në informacionet me karakter publik prej 1 janar deri 31 dhjetor të vitit 2008**

#### **1. Hyrje**

Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për çasje të lirë në informacione me karakter publik, (në tekstin e mëtejshëm Komisioni) që tre vite e zbaton Ligjin për çasje të lirë në informacione me karakter publik (në tekstin e mëtejshëm Ligji) i sjellur në vitin 2006.

Raporti i sivjetëm si obligim ligjor, e kahëzua kah tregimet, notat dhe gjendjet që vijnë:

- Karakteristikat e zbatimit të Ligjit gjatë vitit 2008;
- Notimi i sjelljeve të pjesëmarrësve në procesin e çasjes së lirë në informacionet me karakter publik;
- Të përballura dobësitë në këtë periudhë;
- Organizimi i trajnimeve dhe promovimi i të drejtës së re për çasje të lirë në informacionet me karakter publik;
- Mburra e qytetarëve si kërkues që ta shfrytëzojnë këtë të drejtë kushtetuese, përkundër heshtjes së poseduesve, si problem më i madh në praktikë.

Zbatimi i ligjit në vitin 2008 ishte nxitëse në lëminë e ndërtimit të sistemit. Sot Komisioni disponon me të dhënat themelore për 1460 posedues të informacioneve me karakter publik, por edhe më tej mendojmë se ky nuk është numri definitiv. Në vitin e kaluar është rritur numri i kërkesave, ka 1876 prej të cilave në 1765 raste kërkuesit e kanë realizuar të drejtën e tyre për çasje në informacionet e kërkuara. Edhe pse ndoshta tingëllon si absurde, mburr edhe ajo se dyfish është rritur numri i ankesave në krahasim me vitin e kaluar – gjithsej ishin 670.

Pse kjo do të mburte? Për shkak se rritet numri i qytetarëve të cilët e dijnë të drejtën dhe procesin e tyre për realizimin e tij dhe nuk kanë frikë që ta zbatojnë...

Njëkohësisht, edhe më tej ekzistojnë shkatërrimet, veprimet e pamenduara dhe moskuptimet e njejta (me qëllim apo nga padituria), që japin vërejtje! Numri i poseduesve të cilët nuk e kanë kryer obligimin ligjor që të dorëzojnë raport vjetor është mbi 50 përqind nga numri i përgjithshëm i poseduesve – 1460. Lloj të azhurimit të këtillë treguan posedues të pjesërishëm nga të gjitha strukturat – nga çerdhet për fëmijë e deri në institucionet shtetërore të nivelit qendror dhe lokal. Kjo duket se inauguron një shikim të ri të heshtjes së poseduesve, gjegjësisht nuk ka rrefuzime dhe atë kah Komisioni i obliguar që ti shumojë rezultatet e përgjithshme nga poseduesit, si obligim ligjor.

Karakteristikë për zbatimin e Ligjit në vitin 2008 është edhe interpretimi i vazhdueshëm i dispozitave të veta nga ana e Komisionit me çka i ndërlihd të pathënat e Ligjit. Posaçërisht ka të bëjë me pjesën e procedurës, afateve dhe zbatimin e Ligjit

për procesin e përgjithshëm administrativ. Afatet e gjata në procesin e marrjes së dokumenteve të kërkuara në mënyrë indirekte i çkurajon qytetarët që ta shfrytëzojnë këtë të drejtë të tyre. Pas debateve të shpeshta në këtë temë, me iniciativë të OBSE, Fondacioni Instituti shoqëri e hapur Maqedoni, Ministria e drejtësisë dhe Komisioni, del plani verzioni për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e të drejtës për çasje të lirë në informacionet me karakter publik, i cili tanimë është dorëzuar në Ministrinë e drejtësisë në procedurë të mëtejshme.

Përvojat e Komisionit të hasura mbi 43 mbledhje të mbajtura në vitin 2008 apo gjithsej 112 mbledhje në dy vite e gjysmë punë solli në plan verzionin që të hyjnë më shumë vendime konkrete për përmirësimin dhe lehtësimin e çasjejs në dokumentet me karakter publik dhe për efikasitetin e vet Komisionit. Fakti se Komisioni në vitin 2008 gjithsej solli 215 vendime dhe 426 përmbyllje fjalime në favor të notës se edhe përsërisht mangësive dhe të pathënave të Ligjit, ai jeton, zbatohet dhe e kryen funksionin e vet në mjet efikas demokratik.

Problemi më i madh në punën e Komisionit dhe në dhënien e jetës së Ligjit është “status quo” në krahasim me heshtjen e poseduesve apo paraqitjes së rrefuzimit të heshtur. Mendojmë se pjesërisht bëhet fjalë për mosnjohje të të drejtës së re, kurse pjesërisht për traditën e mbyllur të cilën se kanë tejkaluar akoma.

Mendojmë se nuk është pa rëndësi edhe aktiviteti ndërkombëtar i Komisionit, i cili është rregullisht prezent në mbledhje të rëndësishme ndërkombëtare nga lëmia e lirisë së informacioneve, ku mes tjerash është shikuar se ligji maqedonas është në nivel të njëjtë me vendimet europiane në këtë lëmi, posaçërisht në përfshirjen e gjërë të poseduesve. Përvojat e deritanishme janë të ndryshme, në varshmëri nga rrënjët e traditave demokratike në çdo vend.

Mbi gjithash, si përmbyllje mund të thuhet se edhe në vitin 2008 vazhdoi zbatim të suksesshëm dhe efektiv të Ligjit, nëpërmjet vetëdijes së përforcuar dhe mburrje të pjesëmarrësve në procesin e çasjes së lirë, posaçërisht të qytetarëve.

Trajnimet, promovimi dhe edukimi ishin lëvizja e përparimit, kurse ato të njetat edhe më tej mbesin detyra kryesore dhe prioritet në punën e Komisionit.

## **2. Kompetencat e Komisionit**

Komisioni nëpunën e tij dhe në sjelljen e vendimeve është i pavarur në pajtueshmëri me kompetencat ligjore. Komisioni për punën e tij përgjigjet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, ku edhe dorëzon Raport vjetor.

Komisioni është i përbërë prej 5 anëtarëve: Kryetari, Zëvendëskryetari dhe tre anëtarë, prej të cilëve njëri është përfaqësues nga sektori joqeveritar, kurse dy të tjerët janë nga rendi i Shërbimit profesional të Komisionit, të emërtuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me mandat prej 5 viteve, me të drejtë që përsëri të zgjedhet.

Komisioni punët e kompetencës së tij, si i pavarur, trup kolektiv i kryen në mbledhje. Mënyra dhe puna gjatë vendimit janë të rregulluara me Statut, për të cilën pajtueshmëri dha Kuvendi i republikës së Maqedonisë.

Komisioni, në pajtueshmëri me nenin 32 nga Ligji, i kryen kompetencat në vijim:

- vendos në ankesa kundër vendimit dha përmbylljes me të cilin poseduesi i informacionit e ka refuzuar kërkesën e kërkuesve për çasje në informacione;
- kujdeset për zbatimin e dispozitave nga ky ligj;
- përgatit dhe shpall listën e poseduesve të informacioneve;
- jep mendime për propozimet e ligjeve me të cilat rregullohet çështja e lirë në informacione;
- ndërmerri aktivitete në planin e edukimit të poseduesve të informacioneve që kërkuesve tu mundësojë çasje të lirë në informacione me të cilat ata disponojnë;
- bashkëpunon me poseduesit e informacioneve në kuadër të realizimit të të drejtës për çasje të lirë në informacione;
- jep propozime për mjetet e nevojshme për punën e Komisionit gjatë përgatitjes së Buxhetit të Republikës së Maqedonisë;
- sjell Rregullore për punë të tij;
- përgatit Raport vjetor për punën e tij dhe e dorëzon në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë;
- kryen punë në bashkëpunim ndërkombëtar lidhur me zbatimin e obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë, pjesëmarrje në zbatimin e projekteve të organizatave ndërkombëtare dhe bashkëpunon me organet dhe institucionet e vendeve tjera nga lëmia e çasjes së lirë në informacione me karakter publik;
- sjell Statut, si dhe akte tjera me të cilat e rregullon mënyrën e punës dhe organizimit të Komisionit dhe
- kryen punë tjera të vërtetuara me këtë apo ligj tjetër.

Punët drejtuese, profesionale dhe punët tjera administrativo – teknike, në pajtim me Ligjin, i kryen Shërbimi profesional i Komisionit. Sipas Rregullores për organizim të brendshëm dhe Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Shërbimin profesional të komisionit, janë formuar dy Sektore: Sektori për zbatim me ankesa, punë juridike, të përgjithshme, edukative dhe punë analitike dhe Sektori për bashkëpunim me poseduesit e informacioneve, informimin e publikut dhe bashkëpunim ndërkombëtar në lëminë e pasjes së lirë në informacione me karakter publik. Sipas rregulloreve të cekura, janë sistematizuar 29 prej të cilave janë plotësuar vetëm 15 vende të punës. Nga këto me arsimim të lartë janë 11, kurse 4 me arsimim të mesëm. Me strukturë kualifikuese nga të punësuarit me arsimim të lartë 4 janë jurist të diplomuar, 3 me Fakultet filologjik, 3 me Fakultet filozofik dhe 1 gayetar i diplomuar. Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve 10 janë maqedonas, kurse 5 janë shqiptar.

Numri i vendeve të punës të plotësuara i cili është rreth 50% nga vendet e punës të sistematizuara.

## **2.1 Vendimi për ankesa**


Në vitin 2008 në Komision ishin të dorëzuara gjithsej 670 ankesa në krahasim me vitin 2007, kur në Komision ishin dorëzuar 330 ankesa, që do të thotë se numri i ankesave dy herë është më i madh.

Numri i ankesave të dorëzuara në muaj është: në janar janë dorëzuar 15, në shkurt 8, në mars 8, në prill 7, në maj 138, në qershor 397, në korrik 8, në gusht 1, në shtator 3, në tetor 33, në nëtor 22 dhe në dhjetor 30 ankesa.

Nga numri i përgjithshëm i 670 ankesave, 100 janë dorëzuar nga persona fizik, përdërisa 570 ankesa janë dorëzuar nga shoqata të qytetarëve, prej të cilëve një numër i madh janë nga Forumi rinor arsimor – Shoqata e qytetarëve (FRA 522 ankesa).

FRA në bashkëpunim me Fondacionin Instituti shoqëri e hapur Maqedonia, zbatoi projekt qëllimi i së cilit ishte që të vlerësohet se si implementohet Ligji nga ana e poseduesve dhe nga ana e Komisionit. Projekti ishte i kahëzuar kah institucionet me arsimim të lartë në republikën e Maqedonisë.

Komisioni me të punësuarit pati sukses me angazhim të plotësuar dhe maksimal që në kohë të veprjës me të gjitha ankesat të cilat ishin dorëzuar në afat relativisht të shkurtër prej 40 ditëve jo të plota.



**Grafikoni 1 Ankesa të dorëzuara në muaj në vitin 2008**

Nga 670 ankesa të dorëzuara në Komision, 604 ankesa janë për shkak të heshtjes së administratës. ankesat tjera janë dorëzuar në baza të ndryshme dhe atë: 46 ankesa kundër përgjigjes së poseduesit, 10 ankesa janë dorëzuar kundër vendimeve apo përmbylljeve të poseduesit, 10 ankesa janë dorëzuar për shkak mos zbatimit të vendimeve të Komisionit nga ana e poseduesve të informacioneve.

### 2.1.1 Procesi për ankesë

Të drejtë në mbrojtje juridike ka vetëm kërkuesi i cili ka dorëzuar kërkesë me shkrim për çasje të lirë në informacione.

Ankesa drejtpërsëdrejti dorëzohet në Komision, në pajtueshmëri me Ligjin, kurse nëpërmjet poseduesit të informacionit, sipas Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative. Përderisa ankesa është e dorëzuar drejtpërsëdrejti në Komision ai menjëherë pas marrjes, e dorëzon te poseduesi i informacionit, i cili menjëherë duhet të dalë për ankesë dhe në Komision ti dorëzojë të gjitha shënimet për lëndën.

Duke zgjedhur ankesën, Komisioni mundet:


- ta hudhë ankesën
- ta rrefuzojë ankesën
- ta pranojë ankesën dhe ta detyrojë poseduesin e informacionit që ta japë informacionin e kërkuar
- ta pranojë ankesën dhe lëndën ta kthejë në riprocedurë dhe
- ta ndërpresë procedurën.

### 2.1.2 Lëndë të zgjedhura dhe struktura e tyre

Në vitin 2008 komisioni mbajti 43 mbledhje, në të cilat ka vepruar në **670 ankesa** dhe përgjigje në shumë obligime tjera ligjore. Për 642 ankesa Komisioni solli vendim apo përmbyllje, kurse 28 ankesa janë bartur për përpunim në vitin 2009.

Komisioni, në bazë të këtyre 642 ankesave, në pajtueshmëri me Ligjin, solli gjithsej 215 vendime dhe 427 përmbyllje, prej të cilave:

- **151** vendime me të cilat ankesa pranohet
- **56** vendime me të cilat ankesa rrefuzohet
- **9** vendime me të cilat ankesa hudhet
- **426** përmbyllje me të cilat procedura e ankesës ndërpritet për shkak se kërkuar iu është dorëzuar informacioni i kërkuar.



**Grafikoni 2** Vendime dhe përmbyllje të sjellura

Nga të dhënat e përmendura për procedurën e ankesave, mund të përmbyllet se poseduesit kundër të cilëve është paraqitur ankesë, kanë vepruar në kërkesën e kërkuarit menjëherë pas pranimit e ankesës (gjegjësisht atëherë kur ajo iu është dërguar nga Komisioni), para sjelljes së vendimit nga ana e Komisionit. Kjo shihet edhe nga numri i madh i përmbylljeve të cilat i ka sjellur Komisioni. Do të thotë, shpesh herë pas intervenimit nga Komisioni, kërkuarve iu është siguruar çasje në informacionin e kërkuar.

Njëkohësisht e vërteton dhe e konstaton se me pak dëshirë, dituri dhe me përgjegjësi të madhe, poseduesit kanë mundur të veprojnë për kërkesat e kërkuarve edhe para dorëzimit të ankesës dhe tua japin informacionin e kërkuar, me çka do ta përforcojnë besimin e tyre në pushtet dhe në përgjithësi në institucionet publike dhe te personat juridik apo fizik të cilët kryejnë autorizime publike, dhe njëkohësisht do të tejkalohet administrimi i panevojshëm gjatë dorëzimit të ankesave si dhe shpenzimet e panevojshme dhe përgjegjësia penale.

### **2.1.3 Ankesa të dorëzuara kundër poseduesve të informacioneve**

Gjatë vitit 2008 në Komision janë dorëzuar ankesa kundër poseduesve të informacioneve që vijojnë:

- **108** ankesa kundër institucioneve shtetërore,
- **13** ankesa kundër pushtetit gjyqësor,
- **7** ankesa kundër vetqeverisjes lokale,
- **4** ankesa kundër ndërmarrjeve publike dhe ente të cilat kryejnë veprimtari me interes publik,
- **2** ankesa kundër shoqërive aksionare,
- **529** ankesa kundër institucioneve arsimore,
- **3** ankesa kundër partive politike dhe
- **4** ankesa kundër organizatave dhe shoqatave të qytetarëve.

Institucione shtetërore -108
Pushteti gjyqësor -13
Vetqeverisja lokale -7
Ndërmarrje publike dhe... – 4
Shoqëri aksionare -2
Institucione arsimore -529
Parti politike -3
Organizata dhe ... -4

### **Grafikoni 3 Ankesa kundër poseduesve të informacioneve**

## **2.1.4 Karakteri i ankesave të dorëzuara**

Kërkuesit e informacioneve shpesh herë kanë dorëzuar ankesa kundër shkurtimit të të drejtës për çasje në informacione gjegjësisht kundër mosdhënies së informacionit të kërkuar në formë dhe mënyrë të cekur në kërkesë, dhe kanë të bëjnë me:

Disponim me mjete të buxhetit gjegjësisht me mjete donuese, projekte ndërkombëtare dhe të vendit, investime, furnizime publike të organeve shtetërore, ligjshmëri të procesit për dhënie e lejeve të ndryshme (gjegjësisht për ndërtim të objekteve), të drejta pasurie – personale dhe pronësore, rroga dhe tjera nga Buxheti, plane strategjike të ministrive, rregullore për organizim dhe sistematizim dhe akte tjera, mbrojtje të mjedisit jetësor, gjykime të gjyqeve, dokumente nga katastri, informacione nga lëmia e arsimimit, mbrojtje shëndetësore, vendime, fushata dhe projekte të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, dokumente për objekte ndërtimore, apo objekte në ndërtim, anëtarë të këshillave drejtuese të poseduesit, sa mjete nga Buxheti janë ndarë për aktivitetet e sektorit qytetar etj.

## **2.1.5 Gjendja e lëndëve pas ankesave**

Mbrojtja e të drejtës për çasje të lirë në informacione me karakter publik sigurohet nëpërmjet Komisionit, kurse mbrojtja gjyqësore e Gjykatës drejtuese.

Në pajtueshmëri me Ligjin, kundër vendimit apo përmbylljes së Komisionit, mund të dorëzohet ankesë për kontest administrativ në Gjykatën drejtuese.

Në vitin 2008 në Gjykatën drejtuese u dorëzuan 57 padi, prej të cilave 55 kundër vendimeve të Komisionit, kurse 2 kundër përmbylljeve të Komisionit.

Si shkas për dorëzimin e padive kundër vendimeve të Komisionit në 32 raste, është mosveprimi i poseduesve të informacioneve për vendimet e sjellura të Komisionit, me të cilat shpesh herë detyrohen që ta japin informacionin e kërkuar apo lënda kthehet në rishqyrtim. Në 23 raste paditë janë të dorëzuara kundër vendimeve të Komisionit, me të cilat ankesa e kërkuesit rrefuzohet si e pabazë apo hudhet.

Kundër përmbylljeve të Komisionit janë dorëzuar 2 padi.

Për të gjitha paditë Komisioni veprroi dhe dorëzoi përgjigje në Gjykatën drejtuese.

Në rastin 51 si paditës paraqiten persona fizik, kurse të 6 padi tjera janë dorëzuar nga persona juridik.

## **3. Zbatime dhe përvoja nga zbatimi i Ligjit**

Në pajtueshmëri me kompetencat e veta ligjore, Komisioni është i obliguar që të kujdeset edhe për zbatimin e dispozitave të këtij Ligji.

Komisioni çdoherë e ka parasysh të drejtën themelore njerëzore për çasje në informacione me karakter publik, të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë (neni 16). Çasja në informacione mund fitohet vetëm në raste rreptësisht të posaçme të cilat janë të parapara me ligj, e jo në bazë të të drejtës diskretive të individëve.

Me qëllim për zbatimin e dispozitave të Ligjit, personat zyrtar të Komisionit çdo ditë komunikojnë me personat zyrtar për ndërmjetësim me informacione të poseduesit e informacioneve dhe me kërkuesit e informacioneve. Kërkuesve të informacione iu tregohen të drejtat, kurse poseduesve të informacioneve për obligimet të cilat për ata rrjedhin nga zbatimi i dispozitave të Ligjit. Në këtë mënyrë bëhet njohje e drejtpërdrejtë me ligjin e subjekteve që kanë të drejtë ta përdorin dhe subjekteve të cilët janë të obliguar ta zbatojnë. Angazhimi i këtillë i personave zyrtar dhe i të punësuarve të tjerë në Komision kontribuon për ngritjen e vetëdijes për rëndësinë dhe mënyrën e realizimit të të drejtës për çasje të lirë në informacione dhe implementim më efikas të këtij Ligji.

Është fakt se një numër i madh i qytetarëve akoma nuk janë të njoftuar me të drejtën dhe mundësinë të kërkojnë dhe të marrin informacione të cilat u nevojiten, në pajtueshmëri me këtë Ligj. Por prap se prapë, numri i qytetarëve të cilën kanë dorëzuar kërkesë për çasje të lirë në informacione me karakter publik vazhdimisht rritet. Gradualisht qytetarët e njohin këtë të drejtë të tyre dhe po të njejtën e përdorin.

Edhe përsëri që në zbatimin e dispozitave të Ligjit ka përparim të poseduesit e informacioneve, poashtu na frikëson fakti se edhe në vitin 2008, një numër i madh i ankesave të dorëzuara është për shkak të “heshtjes së administratës”. Poseduesit e informacioneve nuk përgjigjen në kërkesat në afatet dhe format e parapara në Ligj. Në të shumtën e rasteve mundësojnë çasje në informacionin e kërkuar apo e rrefuzojnë çasjen edhe pas dorëzimit të ankesës.

Përrjashtimet nga çasja e lirë janë të numëruara në 9 pikë (neni 6 i Ligjit) dhe vetëm në bazë të këtyre përjashtimeve mund të rrefuzohet çasja.

Në Ligj nuk ka përjashtim absolut nga çasja e lirë në informacione. Çdoherë kur informacioni i kërkuar parqet përjashtim nga çasja e lirë e rregulluar me Ligjin, poseduesi i informacionit është i obliguar të vlerësojë se a është më i madh apo më i vogël interesi i cili mbrohet me mos shpalljen e informacionit në krahasim me interesin publik i cili do të arrihet me shpalljen e informacionit. Përderisa interesi i cili mbrohet me mos shpalljen e informacionit është më i vogël se interesi publik, atëherë poseduesi i informacionit është i obliguar që të mundësojë çasje. Në këtë rast poseduesi i informacioneve është i detyruar që të bëjë testimin e dëmit. Përderisa dëmi i cili do të ndodhte me shpalljen e informacionit është më i vogël se interesi publik, poseduesi është i obliguar që ta japë informacionin e kërkuar.

Për shkak të zbatimit të suksesshëm të Ligjit, janë parapara dispozita kundërvajtëse për poseduesit e informacioneve të cilët nuk do të plotësojnë obligimet të cilat rrjedhin po nga i njëjti apo gabimisht do të zbatojnë dispozitat e tij.

Gjithashtu, për zbatim efikas të dispozitave të Ligjit, është i patjetërsueshëm, ndryshimi i tij, në pajtueshmëri me Ligjin për kundërvajtje. Me këto ndryshime do të përforcohen kompetencat e Komisionit dhe ai do të ketë autorizim që të mund drejtpërsëdrejti të shqiptojë sanksionet kundërvajtëse të parapara në Ligj.

Në Republikën e Maqedonisë Ligji zbatohet prej 1 shtatorit të vitit 2006, dhe paraqet hap të rëndësishëm drejt demokratizimit të shoqërisë, poashtu për shkak të karakterit personal antikorrupsion.

Komisioni gjatë veprimit për realizimin e të drejtës për çasje të lirë në informacione me karakter publik si një ndër të drejtat themelore njerëzore e zbaton Ligjin për çasje të lirë në informacione me karakter publik si **lex specialis**.

Për çështje të cilat nuk janë të rregulluara me Ligjin për çasje të lirë në informacione me karakter publik, Komisioni është i drejtuar që ta zbatojë Ligjin për procedurën e përgjithshme juridike, me çka vepron ngadalë, shpesh herë joefikas dhe i çmburr qytetarët që ta përdorin të drejtën e tyre të re për çasje në informacione me karakter publik. Kjo poasçërisht është e shprehur kur ankesa është dorëzuar për shkak të “heshtjes së administratës” dhe procedura për ankesë zgjatet edhe deri në 60 ditë, kurse e tërë procedura drejtuese pas kërkesës zgjat edhe deri në 90 ditë.

Problem në punën e Komisionit paraqet definicioni i pamjaftueshëm preciz i vërtetuar për interesin publik i cili me rekomandim nga ekspertët e kësaj lëmie, duhet të vërtetohet vetëm me ligj. Në mungesë të rregullores ligjore poseduesi i informacionit ka të drejtë diskretive që të vërtetojëse çka është interesi publik dhe a është ai problem më i madh apo më i vogël se sa dëmi që do të ishte bërë me shpalljen e informacionit të kërkuar. Praktika e deritashme e Komisionit tregon se kjo e drejtë shpesh herë keqpërdoret nga ana e poseduesve të informacioneve në dëm të kërkuarëve të informacioneve.

Që nga fillimi i zbatimit të Ligjit e deri në fund të vitit 2008, vendime të caktuara të Ligjit ishin mjet kritikues i më shumë ekspertëve, të vendit dhe organizata ndërkombëtare joqeveritare, prej ku doli edhe iniciativa nga sektori joqeveritar për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për çasje të lirë në informacione me karakter publik.

Për atë qëllim, në shtator të vitit 2008 me iniciativë të Misionit të OBSE-së në Shkup dhe Fondacionit Instituti shoqëria e hapur Maqedoni, u formua grupi punues për ndryshime dhe plotësime të Ligjit, ku përsëri iniciatorëve morrën pjesë edhe përfaqësues të Ministrisë së drejtësisë, ekspertë nga Fakulteti juridik, anëtarë të Komisionit dhe përfaqësues nga Shërbimi profesional të Komisionit. Teksti i përgatitur punues për ndryshime dhe plotësime të Ligjit, ishte dorëzuar në Ministrinë e drejtësisë në procedurë të mëtejshme.

Në bazë të Ligjit për çasje të lirë në informacione me karakter publik dhe ligjeve tjera në Republikën e Maqedonisë shënohen mospajtime të caktuara të dispozitave të Ligjit me ligje tjera si për shembull Ligji për procedurë penale, Ligji për procedurë kontestuese dhe Ligji për procedurë të përgjithshme drejtuese. Në ligjet e cekura zbatohen dispozita me të cilat çasje në informacione të caktuara iu lejohet vetëm personave të caktuar apo dhënia e informacionit kushtëzohet me tregimin e interesit “të arsyeshëm” apo “të bazuar” për çasje në informacionet me karakter publik dhe marrëveshjet ndërkombëtare nënshkruar i së cilave është edhe Republika e Maqedonisë. Për atë këto arsye në këtë periudhë raportuese gjykatat (pushteti gjyqësor), rrefuzonte që ti jepte gjykimet duke u thirrur vetëm në ligjet procedurale dhe duke i pamundësuar edhe shqyrtim edhe Komisionit edhe pse anëtarët e Komisionit posedojnë qertifikatë.

Republika e Maqedonisë si shtet nxitës i marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat janë të ratifikuara në pajtrueshmëri me nenin 118 të Kushtetutës dhe janë bërë pjesë përbërëse e rendit të brendshëm juridik dhe nuk mund që të ndryshohen me ligj,

patjetër duhet të kujdeset për marrëveshjet e lartpërmendura dhe të njejtat ti ndërtojë në ligjdhënien pozitive dhe ato të jenë të përshtatshme me Ligjin për çasje të lirë si **lex specialis** për çasjen e lirë.

Deklarata për çasje në informacione, e cila në dhjetor të vitit 2004, bashkarisht e miratuan lajmëruesi special i Kombeve të bashkuara për lirinë e mendimit dhe të të shprehurit, përfaqësuesi i OBSE-së për lirinë e medimeve dhe lajmëruesi special i Organizatës së shteteve amerikane për lirinë e të të shprehurit është imperativ në pikëpamje të asaj se në rast të kundërshtimeve, Ligji për çasje të lirë në informacione **ka prioritet** në krahasim me të gjitha ligjet tjera.

#### 4. Lista e poseduesve të informacioneve

Me qëllim që personave fizik dhe juridik tu mundësojë çasje në numër sa më të madh të poseduesve të informacioneve me karakter publik, Shërbimi profesional i Komisionit edhe në vitin 2008 vazhdimisht i regjistroi ndryshimet te poseduesit e informacioneve dhe plotësimet Listës së poseduesve me institucione të reja shtetërore, enete dhe shërbime publike, ndërmarrje publike dhe persona fizik dhe juridik të cilët kryejnë autorizime dhe veprimtari me karakter publik. Me çasjen e këtillë Lista e poseduesve të informacioneve me karakter publik u zgjërua dhe numri i tyre të vitit 2008 arriti **1460**.

Angazhimin për numër sa më të madh të poseduesve, Komisioni pati sukses që ta realizojë me kontakte të vazhdueshme personale dhe me kontakte nëpërmjet telefonit me ata posedues të informacioneve me karakter publik të cilët vet nuk u paraqitën në Komision, si dhe me distribuimin e **14** intervenimeve, lajmërimi dhe apele, të dërguara me postë, të shpallura në gazetatat ditore apo të prezantuara në uebfaqen, me të cilat insistoheshte që poseduesit ti zbatojnë obligimet që rrjedhin nga Ligji (neni 8 dhe 9).

Rritje më të madhe të poseduesve të evidentuar është vërejtur në institucionet shtetërore me 28 subjekte të rejame çka numri i tyre i përgjithshëm arriti **214**. Në këtë periudhë raportuese trendi i formimit të institucioneve të reja në të gjitha shkallët e arsimit në republikën e Maqedonisë rezultonte me evidentimin e 26 poseduesve të rinj, me çka numri i Listës së poseduesve të informacioneve nga lëmia e arsimit është **511**.

Rritje e numrit të poseduesve të informacioneve me karakter publik është vërejtur dhe evidentuar edhe në ndërmarrjet publike, numri i sëcilëve është **333**. Gjatë vitit të kaluar te personat juridik dhe fizik të cilët kryejnë autorizime publike, te shoqëritë aksionare numri i evidentuar me plotësime është **116**. Në grupet tjera të poseduesve të informacioneve me karakter publik të ndara me veprime në krahasim me vitin 2007 numri është pothuajse identik.

deri në fund të vitit 2008 në Listën oficiale të poseduesve të informacioneve me të cilin disponon Komisioni gjithsej janë evidentuar **91** posedues të informacioneve nga pushteti gjyqësor, **86** komuna, ku bëjnë pjesë edhe Qyteti i Shkupit dhe Bashkësia e njësisive të vetqeverisjes lokale, **19** parti politike, **90** ente shëndetësore dhe organizata, (vitin e kaluar 93). Ky trend i uljes është si rezultat i

shuarjes së institucieve të caktuara shëndetësore, apo të ndryshimeve që janë bërë në strukturë të tyre personale.

Institucione shtetërore – 214
Institucione arsimore – 511
Pushteti gjyqësor – 91
Komuna dhe Qyteti i Shkupit – 86
Ente shëndetësore – 90
Parti politike – 19
Ndërmarrje publike – 333
Persona juridik dhe fizik – 116

#### **Grafikoni 4 Lista e poseduesve të informacioneve**

Me letra të posaçme qarkore vazhdimisht nga **298** institucionet të cilat vitin e kaluar akoma nuk kishin caktuar person zyrtar, si dhe nga **67** poseduesve të rinj të regjistruar në vitin raportues 2008, është kërkuar që ta plotësojnë këtë obligim ligjor, me çka Lista e poseduesve u rrit për **100** persona zyrtar të caktuar për ndërmjetësim me informacionet me karakter publik.

Në atë mënyrë numri i përgjithshëm i institucioneve të cilët kanë caktuar persona zyrtar u rrit në **1195** përderisa **265** posedues të informacioneve të evidentuar zyrtarisht nuk i zbatuan obligimet që dolën nga Ligji.

#### **4.1 Përmbajtja e raporteve vjetore**

Edhe në vitin e tretë kalendarik nga zbatimi i Ligjit, në një numër të madh të raporteve vjetore të dorëzuara në Komision, personat zyrtar nuk kanë evidentuar kërkesa për çasje të lirë. Në raportet e këtyre institucioneve janë paraqitur vetëm ndryshimet që janë bërë te personat zyrtar, apo në gjeneralet tjera për institucionin, të cilët për qytetarët – kërkuarit janë të rëndësishëm që lehtë, shpejtë dhe saktë të locohet informacioni i kërkuar te poseduesi.

Raportet e këtyra vjetore në të cilat qëndron se institucionet nuk kanë pranuar asnjë kërkesë për çasje në informacione me karakter publik në vitin 2008, janë karakteristike kryesisht për çerdhet e fëmijëve, shkollat fillore dhe të mesme, një pjesë e mirë e institucioneve me pushtet gjyqësor, organizatat shëndetësore, por edhe njësi të caktuara të vetqeverisjes lokale.

#### **4.2 Raporti vjetor i poseduesve**

Në pajtueshmëri me obligimet ligjore, Komisioni përgatit Raport vjetor, ku mes tjerash, janë përfshirë të dhëna nga raportet e arritura vjetore të dorëzuara te poseduesit e informacioneve me karakter publik.

Në afatin e caktuar në Ligjin për dorëzime të raporteve vjetore për vitin 2008, në Komision prej gjithsej **1460** poseduesve të informacioneve me karakter publik, obligimin e plotësuan vetëm **960**.

Gjatë përpunimit të të dhënave të pranuar të theksuara në raporte, Komisioni nuk pati mundësi që ti marë parasysh të dhënat të theksuara në **23** raporte vjetore të pranuar dhe të njejtat ishin të vlerësuara si jo të plota, të paplotësuara apo gabimisht të plotësuara. Gjegjësisht, personat zyrtar dhe përgjegjës të poseduesit e caktuar të informacioneve, edhe pas implementimit trevjeçar të ligjit gabimisht i interpretojnë, zbatojnë dhe nuk i plotësojnë dispozitat që dalin nga ky ligj.

Në vitin raportues 2008 në Komision arritën **189** raporte nga institucione shtetërore, **62** nga pushteti gjyqësor, **76** nga komunat, **45** nga organizatat shëndetësore, **103** nga ndërmarrjet dhe entet, **186** nga institucionet arsimore, **24** nga persona juridik dhe fizik të cilët kryejnë autorizime publike, si dhe **5** raporte të dorëzuara nga parti politike.

Institucione shtetërore – 189
Institucione arsimore – 186
Pushteti gjyqësor – 62
Komuna – 76
Ente shëndetësore – 45
Parti politike – 5
Ndërmarrje publike – 103
Persona juridik dhe fizik – 24

### **Grafikoni 5 Raportet vjetore të poseduesve**

Numrat e grafikoneve tregojnë numrin e rritur të raporteve të dorëzuara nga ana e institucioneve shtetërore. Ka të bëjë me kontaktet dhe edukimet e vazhdueshme të personave të detyruar për ndërmjetësim me informacione me karakter publik nga ana e Komisionit për implementimin e ligjit. Karakteristike për këtë periudhë raportuese është ajo që në raportet e Agjencionit për katastrofë të patundshmërive, Agjencionit për zhvillim dhe përkrahje të bujqësisë, ministrive të finansave, për arsimim dhe shkencë dhe për shëndetësi dhe organe në përbërje të këtyre poseduesve të informacioneve, të locuar në teritorin e Republikës së Maqedonisë.

Nga ana tjetër, karakteristike është e dhëna për numrin e zvogëluar të raporteve të dorëzuara nga shkollat fillore në vitin e kaluar raportues dhe treguan respektimin e dispozitave që dalin nga Ligji. Gjegjësisht, nga katër qytetet e mëdha në Republikën e Maqedonisë ku është koncentruar një numër i madh i institucioneve arsimore fillore, të mesme dhe të larta, nuk dorëzuan asnjë raport vjetor.

Pas shqyrtimit dhe analizimit detal të raporteve vjetore të arritura nga poseduesit e informacioneve në Komisionin u arrit deri në të dhënën se në këtë periudhë raportuese të poseduesit gjithsej janë dorëzuar **1876** kërkesa për çasje të lirë në informacione me karakter publik. Prej atyre pozitivisht janë përgjigjur **1765** kërkesa, përderisa çasja në informacione ka qenë i rrefuzuar për **97** kërkesa. Nga raportet vjetore të prezantuara të poseduesve del se **14** kërkesa kanë qenë të pranuar në fund të vitit të kaluar, kurse për procedim janë bartur në vitin 2009.

- Pozitivisht të përgjegjura
- Të rrefuzuara
- Të bartura në vitin 2009

### Grafikoni 6 Kërkesa të përgjithshme të dërguara te poseduesit

Nëse krahasohen numrat, me raportin e kaluar vjetor, qytetarët në vitin 2008 kanë dorëzuar rreth 500 kërkesa më shumë. Numri i kërkesave të rrefuzuara i cili në krahasim të vitit raportues 2007 është shumë më o vogël, flet për periudhë më transparente dhe më serioze kah çasja e lirë në informacionet me karakter publik nga ana e institucioneve në krahasim me kërkesat e dorëzuara nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë.

Në fokusine interesit të qytetarëve që të kërkohen informacione me karakter publik ishin pushteti ekzekutiv, ligjdhënës dhe gjyqsor. Nga **1876** kërkesate evidentuara në vitin kalendarik të 2008, deri te ata ishin dorëzuar **636** kërkesa.

Karakteristike për këtë periudhë raportuese dhe për shënim është edhe intersi i përmendur për çasje në informacionet me karakter publik me të cilat disponojnë institucionet arsimore. Deri te ata janë dorëzuar **712** kërkesa, që janë identike, kurse numri i tyre lëvizë prej fakultetit në fakultet dhe janë të drejtuara posaçërisht në adresa të fakulteteve shtetërore gjegjësisht në adresat e Drejtorive të rektorëve.

Gjatë vitit 2008 në vetqeverisjen lokale dhe Qytetin e Shkupit janë dorëzuar **266** kërkesa, në partitë politike **94**, në ndërmarrjet publike dhe entet **61**, në ente shëndetësore **48**, te personat juridik dhe fizik të cilët bëjnë autorizime **32** dhe në çerdhet, shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë janë dorëzuar **27** kërkesa.

Çerdhe, shkolla fillore dhe të mesme---	27
Persona juridik dhe fizik -----	32
Ente shëndetësore -----	48
Ndërmarrje publike -----	61
Parti politike-----	94
Vetqeverisje lokale dhe Q. të Shkupit-----	266
Institucione me arsim të lartë-----	712
Pushteti ekzekutiv, ligjdhënës dhe gjyqësor----	636
0 100 200 300 400 500 600 700 800	

### Grafikoni 7 Kërkesa të dorëzuara te poseduesit

Nga përshkrimi i shkurtër të kërkesave të cilat qytetarët i kanë dorëzuar në institucionet shtetërore, ministritë dhe në Qeveri, del se ata janë interesuar për çështje të ndryshme nga lëmia e denacionalizimit, procedura konkrete të tenderit, shpërndarje apo shpenzime të mjeteve nga buxheti, kushte për ndërtim dhe mbrojtje të mjedisit jetësor, vendime të ndryshme për transformimin e ndërmarrjeve, vendime për formimin e trupave koordinues dhe komisione, rregullore për sistematizimin e

vendeve të punës, kërkesa të të dhënave për numrin e punësimeve të reja, për projekte të financuara nga buxheti i shtetit, si dhe informacione për lartësinë e mjeteve për fushata mediale të porositura nga ana e organeve dhe institucioneve shtetërore.

Kërkesat e dorzuara në fakultetet shtetërore kanë të bëjnë me çështjet e veprimtarisë së fakulteteve, mësimit, programeve studimore, kuadrit mësimor, marrëveshje të ndryshme për participime dhe ekskurzione apsolvente, numrin e vendeve të punës gjegjësisht me hapjen e vendeve të punës, pajisje materiale – teknike, dhe para se gjithash çështje nga natyra financiare të cilat kanë të bëjnë me mjetet e mbledhura nga dhënia me çira të hapësirave të caktuara, për lartësinë e kompenzimeve me baza të ndryshme të personave të kyçur në procesin mësimor dhe ngjajshëm.

### **4.3 Bashkëpunim me personat zyrtar të poseduesit**

Në vitin 2008 gjithsej **265** posedues të evidentuar në listë nuk e respektuan dispozitën e nenit 8 të Ligjit i cili obligon që të përcaktojnë më së paku një person zyrtar për ndërmjetësim me informacione me karakter publik. Me këtë raport të papërgjegjshëm edhe përkaj paralajmërimeve, intervenimeve dhe apeleve të shumta nga ana e Komisionit këta posedues të informacioneve qytetarëve ua shkurtojnë të drejtat që të marrin ndihmë gjatë dorëzimit të kërkesës dhe marjes së përgjigjes në kohë.

Nga ana tjetër praktika flet se në një numër të madh të institucioneve, personat zyrtar obligimin për implementimin e Ligjit e nënkuptojnë si detyrë me rëndësi të shkallës së dytë gjegjësisht si obligim shtesë i cili mund të përpunohet edhe pasi që do të realizohen obligimet të cilat për ata dalin në pajtueshmëri me rregulloret për sistematizim.

Persona të caktuar zyrtar dhe përgjegjës, rastësisht apo me qëllim, harrojnë që në Komision të dorëzojnë lajmërim për ndryshimet e bëra në emrin e institucionit të tyre, adresë, personi(at) zyrtar i(të) cili(ët) ndërmjetësojnë me informacionet me karakter publik, telefonat për kontakt, e-mail adresat etj. Nuk janë të rralla edhe shembujt kur personat përgjegjës, thjeshtë harrojnë që ti informojnë personat zyrtar se iu është dhënë në besim obligimi që të ndërmjetësojnë me informacionet me karakter publik, dhe atëherë ata janë të habitur, kur qytetarët apo të punësuarit e Shërbimit profesional të Komisionit do tu drejtohen për çfarëdo asistimi në lidhje me implementimin e Ligjit.

Për shkak të gjith kësaj, Komisioni është në gjendje, jo me fajin e vet, që kërkuesve të informacioneve tu prezantojë Listë të poseduesve ku janë të përfshira edhe të dhëna jo të sakta për institucione dhe organizata të caktuara.

Përkundër shembujve të pasakta, për fat të keq, në periudhën raportuese, në kahje pozitive duhet të potencohet apo të theksohet sjellja e personave udhëheqës të institucioneve të reja të sapohapura – Agjencioni për posta, Komisioni shtetëror për ankesa për furnizime publike dhe Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural.

Ata me vetiniciativë në Komision dorëzuan listë të kompletuar me të gjitha të dhënat e duhura për personin zyrtar dhe për listën e informacioneve, si dhe raporte

vjetore. në atë mënyrë poseduesit e përmendur të informacioneve treguan përgatitshmëri për respektimin e të drejtës njerëzore kushtetuese dhe ligjore të garantuar për çasje në informacione me karakter publik.

Në vitin 2008 vazhdoi praktika e institucioneve të caktuar siç janë ministritë për arsim dhe shkencë, finansa dhe për shëndetësi, komuna Kisella Voda, Agjencioni për kataster të patundshmërive, Arkivat nëpër Republikë, në sektore apo shërbime të ndryshme që të kenë persona zyrtar të caktuar.

përkundrazi në praktikën e këtyre në Agjencionin për zhvillim dhe nxitjen e bujqësisë, NP për ekonomizim me hapësirë banesore dhe afariste, NP “Makedonski shumi”, dhe Drejtoria për të hyra publike, autorizimet që të ndërmjetësojnë me informacionet me karakter publik iu janë dhënë vetëm një personi zyrtar.

#### **4.4 Raporte të pakompletuara dhe parregullsi të evidentuara**

Shërbimi profesional i Komisionit për shkak të lëshimeve, parregullsive, joprecizitetit dhe mosnjohje të evidentuara të Ligjit, nuk pati mundësi që ti marrë parasysh numrat dhe të dhënat tjera në gjithsej **23** raporte vjetore të pranuar. Numri i raporteve të pakompletuara apo jo të rregullta është i zvogëluar për **15** në krahasim me Raportin vjetor të vitit 2007. Për fat të keq, nuk është rezultat i cili buron nga përvoja e hasur e personave zyrtar, gjegjësisht nga “leximi preciz” i dispozitave ligjore. Vërtetim për këtë janë edhe shembujt të cilat i prezantojmë në vazhdim, të cilat më së miri flasin për atë se poseduesit, gjithsesi identik si në vitin raportues të 2007 nuk dallon se çka janë kërkesa në bazë të Ligjit, e çka kërkesa të cilat rrjedhin nga fushëveprimi i punës së institucioneve.

Konstatimi i përmendur vërtetohet nëpërmjet shembullit të raportit të Shkollës së lartë të mjekësisë nga Manastiri e cila operon me **250** kërkesa të shënuara, siç qëndron në përshkrimin e shkurtër, në rregulloret e Shërbimit për çështje studentore si dhe kërkesa arhivore të shënuara nga punëtorët, por edhe siç thuhet kërkesa nga subjekte tjera juridike. mes tjerash, kërkesat kanë të bëjnë edhe për ndarjen e mjeteve të qytetarëve për shërim jashtë vendit, ndihmë solidare, për shtypje të librave etj.

Numër më të madh të kërkesave në vitin 2008 ka Njësia për kataster të patundshmërive nga resnja me **9011**, në bazë të Ligjit. Këtu ka të bëjë për zbatim të pamenduar të Ligjit, si dhe jokoordinim dhe mospajtuashmëri, sepse Agjencioni për kataster të patundshmërive të republikës së Maqedonisë në raport të përmbledhur i dorëzuar në Komision për të gjitha njësitë e tij të locuara në vetqeverisjen lokale nëpër tërë shtetin ka regjistruar vetëm **91** kërkesa.

Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Maqedonisë në raport bën prerje detale të aktiviteteve në fushëveprimin e tij, duke dorëzuar informacion të përmbledhur nga e të gjitha njësiteve rajonale. Sipas këtij institucioni, kërkesa në bazë të Ligjit janë dy memorandumet në kompetencë të Fondit të dorëzuara në Ministrinë për punë dhe politikë sociale, si dhe **281** kërkesa nga Gjyqet themelore të dorëzuara për llogaritje për kontribut të papaguar nga ana e Fondit. Fondi që dy vite me rradhë dorëzon raport vjetor jopërkates për kërkesa të informacioneve me karakter publik të pranuar, të zgjedhura pozitivisht dhe të rrefuzuara.

Qendra ndërkomunale për punë sociale nga Kavadari edhe këtë vit dorëzoi raport jovalid, edhe pse maksimalisht në mënyrë pedante janë shënuar disa mijëra kërkesa të pranuar të cilat për fat të keq nuk janë me bazë të Ligjit, por nga lëmia e korespondencës së përditshme dhe nga lëmia e punës së Qendrës. Personat e saj **684** kërkesa për tutor, për realizimin e shtesave për fëmijë, për të drejtën e pajisjeve të fishnjeve të posalindura i llogarisin si kërkesa të pranuar në bazë të çasjes së lirë në informacione me karakter publik.

Në raportet vjetore jo të kompletuara Komisioni e numëroi edhe raportin e Njësisë rajonale të Arkivit shtetëror nga Ohri, ku janë shënuar **1328** kërkesa të pranuar, kurse në pjesën e dytë të posaçme nga raporti janë evidentuar edhe **1520** kërkesa tjera nga palë të cilat janë dhënë për qëllime shkencore dhe informacione lidhur me sferën juridike të pasurisë.

Mosnjohja elementare e problematikës nga sfera e Ligjit, për fat të keq është prezente edhe në raportin që në Komision e dorëzoi Gjyqi i apelit nga Manastiri. Gjegjësisht, personi zyrtar i këtij institucioni gjyqësor tregon **77** kërkesa të pranuar, të cilat siç sqaron, në realitet janë ankesa dhe peticione për punën e gjyqit, zgjatje e procedurave dhe vendimeve të gjyqit.

Raport jo i plotë është edhe ai i Ministrisë për punë dhe politikë sociale që në afatin ligjor e dorëzoi, ku, për fat të keq, nuk përputhet numri i kërkesave të pranuar me numrin e atyre të përgjigjura dhe të rrefuzuara.

#### **4.5 Vetpërgjigjim nga ligji**

Viti i tretë me rradhë nga implementimi i Ligjit në republikën e Maqedonisë edhe përsëri numrit të madh të apeleve, intervenimeve dhe tregimeve të shumta, Lidhja e sindikatëve të Maqedonisë si organizatë më masovike e punëtorëve në shtet nuk i respekton dispozitat nga Ligji.

Duke u thirrur në akte tjera ligjore nëpërmjet të cilave bazohet puna dhe veprimtaria e tyre ata mendojnë se për ata nuk vlejnjë dispozitat e këtij ligji. Në këtë kategori të institucioneve, edhe këtë vit, si vitin e kaluar, numërohen pjesë nga gjithsej 19 banka të evidentuara, 12 kompani siguruese, 64 provajderë kablovik dhe internet, si dhe ShA Ohis –Shkup, gjegjësisht ShA Makpetrol.

Përkundër të lartpërmendurave, obligimin e vet ligjor për vitin e kaluar e respektuan: Stopanska banka – Manastir, IK banka dhe Ziraat banka, kompanitë për sigurim INSIG Makedonija, QBE Makedonija, SAVA Tabak, ShA për sigurim Eurolink, Shoqëria për sigurim SIGMA ShA Shkup dhe Byroja nacionale për sigurim. Në grupin e subjekteve që i zbatojnë dispozitat e Ligjit u numëruan edhe internet provajderët SONET, Ulltra net, Macedonia On-line si dhe Oda ekonomike e Maqedonisë. Këta posedues jo vetëm se kanë caktuar persona zyrtar, por edhe rregullisht dorëzojnë raporte vjetore në afaktin e caktuar me ligj.

Operatorët kablovik Telekabel, Kejbëlltell (të cilët kanë të caktuar persona zyrtar), si dhe internet provajderi On.net (nuk ka caktuar asnjë person zyrtar) këtë vit nuk dorëzuan raport vjetor edhe pse nga viti 2008 e zgjeruan veprimtarinë e tyre edhe me një segment të rëndësishëm me interes të përgjithshëm për të gjithë qytetarët duke u bërë operator të telefonisë fikse.

## **5. Edukim dhe trajnime**

Si një ndër aktivitetet prioritare të Komisionit gjatë vitit 2008 ishte edukimi i personave të obliguar për ndërmjetësim me informacione me karakter publik, nga organet e administratës shtetërore – pushtetit gjyqësor, vetqeverisjes lokale, institucioneve të larata arsimore, përfaqësuesve të ndërmarrjeve dhe enteve publike, shoqërive aksionare etj.

Me trajnimet 33 ditore të mbajtura prej të cilave 20 në Shkup dhe 13 në qendra rajonale në Maqedoni, Komisioni vazhdoi me realizim të plotë të obligimeve që iu janë dhënë me Ligjin, kurse kanë të bëjnë me mundësinë për rrjedhje të pandërprerë të informacioneve me karakter publik në të gjitha lëmitë e jetesës.

33 trajnimet e mbajtura vazhdimisht, në periudhën prill – dhjetor të vitit 2008, me programë paraprakisht të përgatitur, nga ana e Komisionit, i vizituan 480 persona të obliguar për ndërmjetësim me informacione me karakter publik nga pushteti ekzekutiv, ligjdhënës dhe gjyqsor si dhe nga më shumë institucione të cilët kryejnë veprimtari me karakter publik.

Në trajnimet e mbajtura në 13 qendrat rajonale: Ohër, Strugë, Kërçovë, Manastir, Prilep, Veles, Shtip, Koçan, Strumicë, Gjevgeli, Kumanovë, Tetovë, dhe Kavadar morrën pjesë edhe persona zyrtar nga komunat tjera të cilët gravitojnë në këto qendra.

Në trajnimet gjatë promovimit të çasjes së lirë, theks të veçantë u vendos në mënyrat për veprim me kërkesat si dhe për komunikimin mes kërkuarve dhe poseduesve të informacioneve me karakter publik.

Trajnimet e realizuara në vitin 2008 janë pjesë e gjithsej 50 trajnimeve, të planifikuara në kuadër të aktiviteteve për realizimin e Projektit “Ndihmë teknike dhe ngritja e vetëdijes për përkrahjen e vetëdijes për zbatimin e Ligjit për çasje të lirë në informacione me karakter publik” të cilin e zbaton Komisioni në bashkëpunim me Institutin maqedonas për medime, kurse me përkrahje financiare të Ambasadës së Britanisë së Madhe në Republikën e Maqedonisë.

Me dinamikë të ngjajshme trajnimet me nivel lokal – në qendrat tjera rajonale do të vazhdojnë edhe në vitin 2009. Me mbarimin e Projektit, numri i personave të detyruar për ndërmjetësim me informacione me karakter publik të cilët kanë marrë pjesë në takimet edukuese do të ishte rreth 800, prej gjithsej 1195 të regjistruarve në listën e Komisionit. Dallimi mes dy numrave ka të bëjë me mungesën e paarsyeshme e disa personave në trajnime, të cilët nga ana e Komisionit ishin tlfuar në këhë dhe në mënyrë të rregullt.

### **5.1 Transparencë në punën e Komisionit**

Në vitin 2008 Komisioni tregoi përgatitshmëri për bashkëpunim me institucionet të cilat kryejnë autorizime publike. Në atë kontekst nëpërmjet llojeve të shumta të aktiviteteve dhe fushatave, si dhe me bashkëpunim me poseduesit dhe kërkuarët e informacioneve vazhdimisht e afirmoi të drejtën e çasjes në informacione me karakter publik.

Në periudhën raportuese Komisioni u paraqit si organizator apo si bashkorganizator dhe pjesëmarrës aktiv në një numër të madh të punëtorive, tryezave të rrumbullakëta, konferenca dhe në diskutime të shumta ku mori pjesë proaktive, posaçërisht në aspektin e problematikës e cila ka të bëjë me sferën e çasjes së lirë ne informacione me karakter publik.

- Pjesëmarrje e Komisionit në Tryezën e rrumbullakët me temë: “Çasje e lirë në vendime gjyqësore” (në Shtip dhe Shkup). Në Tryezën e rrumbullakët morën pjesë edhe përfaqësues të Misionit monitorues të OBSE-së me seli në Shkup dhe kryetari i Gjykatës administrative të apelit në Stokholm, Suedi.
- Pjesëmarrje aktive në punëtorinë e organizuar nga ana e Akademisë për trajnim të gjykatësve dhe prokurorëve publik me temë: “Çasje në informacione dhe zbatimi i Ligjit për pasje të lirë në informacione me karakter publik dhe Ligjit për mbrojtje të dhënave personale”.
- Pjesëmarrje dhe debatim për projektin e Transparencës – Korrupsion zero me titull: “Monitorim permanent antikorrptiv i prioritetëve kyçe të UE procesit çasës” (i finansuar nga Qeveria e Mretërisë së Norvegjisë). Komisioni, në bashkëpunim me MIM, gjatë vitit 2008 organizoi më shumë ngjarje prej të cilave do ti kishim veçuar më të rëndësishmet:
- Në qershor të vitit 2008 u mbajt Punëtori njëditore për përvojat e zbatimit të deriatëhershëm të Ligjit, ku morën pjesë persona zyrtar nga institucione të ndryshme të republikës së Maqedonisë, Ministri i drejtësisë, si dhe ambasadori i britanisë së Madhe në Republikën e Maqedonisë. Para të pranishmive u promovua edhe uebfaqja e re e Komisionit ([www.komspi.mk](http://www.komspi.mk))
- Me rastin e dyvjetorit të zbatimit të Ligjit për çasje të lirë në informacione me karakter publik, më 1 shtator të vitit 2008 në gazetën ditore “Dnevnik” si shtojcë e posaçme në 44 faqe në tirazh prej mbi 30.000 shembuj u shpall Lista e poseduesve të informacioneve me karakter publik me të gjitha të dhënat. Në këtë mënyrë Komisioni e plotësoi obligimin ligjor (në pajtueshmëri me nenin 5) një herë në vit ta shpallë Listën në mjetet për informim publik.
- Komisioni në bashkëpunim me Institutin maqedonas për medime, në mënyrë të përshtatshme e shënoi dyvjetorin nga zbatimi i Ligjit. Në këtë mënyrë morën pjesë përfaqësues nga Qeveria, nga Ministrinë, deputetë në Kuvendin e republikës së Maqedonisë. ambasadori i britanisë së Madhe në Republikën e Maqedonisë, përfaqësues të sektorit joqeveritar, si dhe persona zyrtar te poseduesit e informacioneve me karakter publik.
- Më 28 shtator të vitit 2008 për herë të tretë nga formimi i tij, Komisioni e shënoi Ditën ndërkombëtare për çasje të lirë në informacione me karakter publik “Kam të drejtë të di”. Në këtë ngjarje para një numri të madh të përfaqësuesve të organizatave joqeveritare dhe ndërkombëtare dhe personave zyrtar për ndërmjetësim me informacione me karakter publik, u promovuan publikimi “Informacionet me karakter publik janë për tu dhënë, e jo për tu ruajtur” dhe plakat-posteri ku është paraqitur i tërë procesi që nga momenti i dorëzimit të kërkesës, e deri në marjen e informacionit. Para të pranishmive u promovua edhe në film i shkurtër i animuar, me çka Komisioni e filloi fushatën

mediale për njohejen e qytetarëve me të drejtën e tyre të re ligjore. Fushata u mbajt gjatë muajit tetor, me çka u emituan gjithsej 14 projekte të filmit në katër termine të televizionit nacional.

Të gjitha këto aktivitete u realizuan me përkrahje financiare të Ambasadës së Britanisë së Madhe, si pjesë e projektit “Ndihmë teknike dhe ngritja e vetëdijes për përkrahjen e zbatimit të Ligjit për çasje të lirë në informacione me karakter publik në Republikën e Maqedonisë”.

## 5.2 Ueb faqja

Me qëllim për ta lehtësuar procedurën për marrjen e informacioneve me karakter publik, kurse njëkohësisht të zbatojë komunikim më të afërt me poseduesit e informacioneve me interes publik, por edhe me qytetarët si kërkues të informacioneve me karakter publik, Komisioni në korrik të vitit 2008 promovoi uebfaqe të re [www.komspi.mk](http://www.komspi.mk)

Intencioni themelor i Komisionit është me ndihmën e ueb portalit në përmbajtje dhe redizajnim vizuel që të sigurojë afirmacion më të madh të Ligjit dhe të të drejtës për çasje në informacione me karakter publik si përfitim demokratik, por njëkohësisht edhe të kontribuojë për transparencë më të madhe të institucioneve të cilat i posedojnë këto lloje të informacioneve. Për atë qëllim, pjesa e re e ueb faqes së Komisionit e rezervuar për lajmet është e zgjeruar, me çka mundësohet plasimi i një numri të madh të informacioneve të vendosura në faqen kryesore. Lajmet dhe informacionet tani plotësisht janë të arhivuara, me çka vizitorëve iu është mundësuar mënyrë e tjeshtë për shfletimin dhe leximin e përmbajtjeve lidhur me aktivitetet e Komisionit, dhe implementimi i Ligjit.

Risi kualitative që del nga puna e Komisionit është vendosja e vendimeve, përmbjlljeve, përgjigjeve të ankesave në uebfaqe të cilat janë sjellur në mbledhjet e Komisionit.

Në funksionin për shfletim më të thjeshtë të përmbajtjeve, por para se gjithash për kërkimin e Listës me poseduesit e deritanishëm të informacioneve me interes publik, është ndërtuar edhe “kërkues” i thjeshtë.

Në ueb faqe në baner të posaçëm është vendosur filmi i shkurtër i animuar, me të cilin filloi fushata mediale për ngritjen e vetëdijes, njohje dhe edukim konkret për qytetarët për të drejtën e tyre kushtetuese për çasje të lirë në informacionet me karakter publik.

Risi e rëndësishme në portalin e Komisionit është e paraparë edhe pjesa për anketim me të cilën një herë në muaj sondohen mendimet e kërkuesve dhe poseduesve të informacioneve, me çka fitohen të dhëna me vlerë për praktikën e mira dhe të këqija nga zbatimi i Ligjit, si dhe për efikasitetin e punës së Komisionit.

Posaçërisht praktik për qytetarët është edhe baneri ku në një vend në formë elektronike janë vendosur formular për çasje në informacione me karakter publik dhe formular për ankesë.

Ueb portali i Komisionit gjatë një dite shënoi prej 120 deri 200 vizita. Numri i përgjithshëm i vizitorëve që nga formimi i Komisionit e deri më 31 dhjetor të vitit 2008 është **94.000**.

### **5.3 Bashkëpunim ndërkombëtar**

Në kuadër të aktiviteteve të Komisionit në planin e bashkëpunimit me komisione të ngjajshme në rajon dhe më gjërë i theksojmë aktivitetet që vijojnë:

- Pjesëmarrje në Konferencën e tretë europiane të komesarëve informativ (komesarë dhe kryetarë të komisioneve për çasje në informacione me karakter publik) në Slloveni në organizim të komesarit Slloven. Në këtë Konferencë u miratua Deklarata e Konferencës së treë europiane për përparimin e të drejtës për çasje të lirë në informacione me karakter publik. Kryetari i Komisionit kishte prezantimin e tij në paraqitjen e Ligjit dhe punës së Komisionit dhe përvojave maqedonase në zbatimin e Ligjit.
- Bashkëpunimi i rregullt dhe kontakte me Ministrinë për kulturë të Republikës së Malit të Zi (kompetente për çështjet e çasjes së lirë në informacione me karakter publik). Kryetari i Komisionit mori pjesë në Konferencën rajonale të vendeve nga Ballkani perëndimor: “Mediat komerciale dhe interesi publik” që u mbajt në Mojkovac (Mali i Zi). Kryetari mori pjesë me temën: “Çasja e lirë në informacione me karakter publik si element kryesor në krijimin e gazetarisë objektive hetimore”. Në Konferencën rajonale me temën: “Çasja e lirë në informacione – të drejtat dhe liritë njerëzore” e mbajtur në Kotor, Mali i Zi, me pjesëmarrje të përfaqësuesve nga Maqedonia, Sërbia dhe Mali i Zi, Kryetari i komisionit kishte prezantim për përvojat dhe punën e Komisionit në Maqedoni.
- Në kuadër të kompetencave të Komisionit Kryetari mori pjesë në përmirësimin e tekstit të Konventës në Këshillin e Europës për çasje në dokumentet oficiale. Gjatë saj u prezantua se ligji maqedonas ka përfshirje më të madhe të poseduesve nga Konventa. Paraqitje të ngjajshme drejtuan edhe komesarët apo ombudsmanët nga dhjetra vende tjera europiane. Këto paraqitje u morën parasysh gjatë shqyrtimit të mëtejshëm të vendimeve në këtë Konventë.
- Pjesëmarrje në vizitë studijuese në Republikën e Austrisë të përfaqësuesve të Komisionit në përbërje të Delegacionit maqedonas me qëllim për përsosjen profesionale të funksionerëve shtetëror në lidhje me problematikën lidhur me E-Qeverinë.

### **6. Buxheti**

Komisioni, në pajtueshmëri me nenin 30, paragrafi 2 të këtij Ligji, në Ministrinë e finansave dorëzoi propozim për përgatitjen e Buxhetit për vitin 2008. Për shkak Planit aksional të vërtetuar më parë të Qeverisë së republikës së Maqedonisë, Komisionit nuk iu miratuan mjetet plotësuese të këruara për zbatimin e funksioneve themelore, që u detyrua që kyçet në kuadër të shumave të mëparshme të planifikuara.

Me Buxhetin e miratuar për vitin 2008 Komisioni në përgjithësi nuk mundi që ti realizojë kompetencat ligjore për afirmimin e çasjes së lirë në informacione me karakter publik: edukimin e personave të detyruar për ndërmjetësim me informacione, prezantimin medial të Ligjit, shpalljen e listës së poseduesve në mediat dhe botimi i publikimeve, buletineve apo broshurave.

Që të realizohen aktivitetet e shënuara, Komisioni në bashkëpunim me Institutin maqedonas për medime, gjatë vitit 2008 vazhdoi me implementimin e Projektit “Ndihmë teknike dhe ngritja e vetëdijes për përkrahjen e zbatimit të Ligjit për Çasje të lirë në informacione me karakter publik në republikën e Maqedonisë”, me përkrahje financiare të Ambasadës së Britanisë së Madhe.

	<b>PËRSHKRIM</b>	Buxheti 2007	Buxheti 2008	Buxheti 2009
	<b>TË DALA</b>			
401	Rroga dhe kompenzime	6.838.000 den.	7.978.000 den.	7.991.000 den.
402	Kontribute për sigurim social të punëtorëve	2.141.000 den.	2.141.000 den.	2.977.000 den.
403	Kontribute themelore të rrogave	21.000 den.	25.000 den.	25.000 den.
420	Të dala për rrugë dhe mëditje	386.000 den.	370.000 den.	370.000 den.
421	Shërbime komunale, nxemje, komunikim dhe transport	1.310.000 den.	1.254.000 den.	1.534.000 den.
423	Mjete dhe materiale tjera për riparim	123.000 den.	118.000 den.	192.000 den.
424	Riparime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme	260.000 den.	189.000 den.	115.000 den.
425	Shërbime kontraktuese	1.833.000 den.	1.755.000 den.	1.755.000 den.
426	Të dala tjera rrjedhëse	1.310.000 den.	1.254.000 den.	1.254.000 den.
483	Blerje të mobiljeve, pajisjeve, automjete dhe aparate	0 den.	60.000 den.	160.000 den.
	<b>Gjithsej:</b>	<b>14.222.000 den.</b>	<b>15.500.000 den.</b>	<b>16.373.000 den.</b>

**Tabela 1 Buxheti i Komisionit**

Nga përshkrimi tabelar mund shihet se qëndrime të pjesërishtme në Buxhet, përveq rrogave, tanimë tre vite me rradhë, janë zvogëluar, gjegjësisht të njejta. Për shkak të Buxhetit të kufizuar Komisioni me përdorim përfundimisht racional të mjeteve të marrura, me qëllim prej qëndrimi në qëndrim në vitin 2008 pati sukses që të pajiset me pajise informative etj. që ishin të patjetërsueshme për kryerje normale të veprimtarisë themelore.